

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Vacation in Albania" SH.P.K

HYRJE

NENI 1

Sot me date 25.08.2025 u nenshkrua Statuti I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Vacation in Albania" sh.p.k Bazuar ne vendimin e ortakut, me date 25.08.2025, ortaket me identitet sa me poshte hartojne statutin e shoqerise, bazuar ne nenin 230/2 I ligjit 9901 date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Znj. Asmaa Al Rabbat, dtl 22.03.1994, lindur ne Siri, dhe banuese ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me Nr. Personal J45322110R.

Z. Feras Aldabak, dtl 01.08.1978, lindur ne Siri, dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me Nr. Personal H80801230I.

me permbajtje sa vijon:

NENI 2

Shoqeria eshe krijuar dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e ketij statuti, Ligjit 9901 dt 14/04/2008 "Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret" si dhe legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

NENI 3

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, I perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA



NENI 4

Emertimi i shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar eshte "Vacation in Albania" sh.p.k.

NENI 5

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Vacation in Albania" sh.p.k ka seline e saj ne Tirane MEZEZ Rruga Nexho Konomi, Blloku Green City, Ndertesa A, Njesia e sherbimit Nr. 11 1001.

Aktiviteti i shoqerise zhvillohet ne rrethin e Tiranës dhe do te shtrihet ne te gjithë teritorin shtetëror te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

 1

OBJEKTI

NENI 6

Objekti I veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Vacation in Albania" sh.p.k eshte ne fushen e :

- Një kompani turistike përgjegjëse për të gjitha shërbimet turistike si turne, ofrimin e shoferëve për grupe dhe familje, turizëm mjekësor dhe terapeutik, ofrimin e investimeve në pasuri të paluajtshme dhe shërbime konsulence, si dhe ofrimin e studimeve për projekte në Shqipëri. Shërbime ndërmjetsimi të pasurive të paluajtshme për blerjen shitjen dhe qiradhenien e shtëpive, tokave dhe pronave. Dhenie me qira AIRBNB të apartamenteve.

NENI 7

Aktiviteti i shoqerise eshte pa afat te caktuar. Per shkaqe e arsye te ndryshme, ajo mund te mbylli kete aktivitet. Kjo do te behet ne perputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit ne fuqi.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 8

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga kontributi i ortakeve I cili zoterohet ne kete menyre:

Znj. Asmaa Al Rabbat zoteron 1 kuote te kapitalit themeltar te shoqerise. Kapitali eshte vleresuar dhe regjistruar ne vleren 50.000 leke (pesedhjetë mijë).

Z. Feras Aldabak zoteron 1 kuote te kapitalit themeltar te shoqerise. Kapitali eshte vleresuar dhe regjistruar ne vleren 50.000 leke (pesedhjetë mijë).

Sipas kontributit te mesiperm kuotat zoterohen si me poshte:



1. Znj. Asmaa Al Rabbat, zoteron 50% te kuotave te kapitalit themeltar.
2. Z. Feras Aldabak, zoteron 50% te kuotave te kapitalit themeltar.

NENI 9

Kapitali themeltar mund te shtohet ose zvogelohet, ne varesi te rezultateve dhe ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

NENI 10

Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise, ose te lihet peng, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



ASMAA

NENI 11

Kapitali themeltar eshte lehtesisht I transferueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshorti, paraardhesi dhe pasardhesit mund te behen ortak ne shoqeri nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit dhe sipas kushteve te parashikuara me ligj.

NENI 12

Shoqeria mund te kete dhe kontribute te tjera ne natyre. Ketu perfshihen te gjitha sendet e paluajtshme ne sherbim te shoqerise si dhe ato te luajtshme, te cilat kalojne ne pronesi te shoqerise.

FONDET E SHOQERISE

NENI 13

Shoqeria percakton fondet:

- Fondi themeltar (qarkullues);
- Fondi reserve;
- Fonde te tjera, qe mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

Madhesia e secilit fond percaktohet mbi bazen e vendimit te organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe per qellimin e perdorimit te tij.

DREJTIMI ADMINISTRATIV.

NENI 14

Shoqeria ka si organe drejtuese:

Ortaket e shoqerise
Dhe Administratori.



Administratori i shoqerise eshte ortaku I vetem Znj. Asmaa Al Rabbat. Administratori eshte i zgjedhur per 5 vjet me te drejte rizgjedhje.

NENI 15

Ortaket per administrimin e shoqerise ose te aktiviteteve te vecanta te saj ka kopetence te emerij nje ose disa persona te tjere si administrator te shoerise. Kompetencat e administratoreve te mundshem percaktohen ne aktin e emerimit te tyre.

NENI 16

Shoqeria nuk merr persiper veprimet qe mund te kryejne administratore te tjere te mundshem, ne marrdhenie me persona te trete qe I tejkalojne kompetencat e tyre te percaktuara ne aktin e emerimit.



3

NENI 17

E gjithë veprimtaria e shoqërisë administrohet nga administratori i saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 18

Administratori për të shqyrtuar bilancin vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe menyrën e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabel, emeron një ose disa eksperte kontabel. Emerimi i ekspertëve kontabel është i detyrueshëm për rastet e parashikuara me ligj.



ORTAKU I VETEM TE DREJTAT DHE DETYRIMET NENI 19

- Përcakton politikën tregëtare të shoqërisë.
- Ndryshimet e statutit.
- Emeron dhe shkarkon administratorët dhe përcakton kompetencat e tyre në aktin e emerimit.
- Përcakton shpërblimin e administratorit, të likuiduesit dhe ekspertëve.
- Mbikqyr zbatimin e politikave tregëtare nga administratorët, pasqyrat financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së shoqërisë.
- Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit.
- Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimin e realizuar.
- Vendosi për krijimin e filialeve, degëve ose përfaqësive të shoqërisë si dhe për krijimin e shoqërive të përbashkëta.
- Vendosi për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e aktivitetit të shoqërisë, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e shoqërisë vlerësohen me humbje.
- Realizon marrëdhëniet me të rëndësishme financiare dhe ekonomike të shoqërisë me persona të tjerë fizikë dhe juridikë.
- Të caktojë dhe shkarkojë drejtues teknik sipas drejtimeve të veprimtarisë që do të ushtrojnë shoqëria (me kontratë punë).
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjes së asamblesë.

MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

NENI 20

Asambleja mbledhet sa herë që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shoqërisë, në rastet e përcaktuara me ligj, e në të gjitha rastet jo më pak se një herë në vit. Ajo thirret nga administrator ose ortakët.


AS meca 4

Thirret me shkresë ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, ditën, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e dites, e t'u dergohet ortakeve jo me vonë se shtatë ditë para dates se parashikuar per mbledhje.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamble vete ose edhe nga nje person i autorizuar prej tij, ose ortak tjetër.

Administratoret nuk mund te veprojnë si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi jepet per nje mbledhje te asamblese me te njejtin rend dite edhe nese vijon me shume se nje dite.

Vendimet merren me shumice te thjeshte vote.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

NENI 21



Administratori i shoqerise ka per detyre:

- Te punoje, te drejtoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare, sipas politikës tregtare te vendosur nga asambleja e pergjithshme.
- Te perfaqesoj shoqerine tregtare.
- Te kujdeset per mbajtjen e saktedhe te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- Te pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar; dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe vazhdimësisë e saj, se bashku me propozimin per shperndarjen e fitimeve dhe paraqit keto dokumenta para asamblese se pergjithshme per miratim.
- Te kryeje regjistrimet dhe te dergoj te dhenat e detyrueshme te shoqerisesic parashikohet ne ligj per QKR.
- Te raportoj para asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare.
- Realizon dhe percakton cmimet e punimeve te kryera si dhe te shitjeve te artikujve te tregtuar.
- Nenshkruan kontrate pune me punemarres.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marrdheniet me organe te ndryshme shtetërore dhe me persona te tjere fizike dhe juridike, lidh kontrata em te trete.

DREJTIMI TEKNIK I SHOQERISE

NENI 22

Per veprimtari ne fusha te vecanta (ne te cilat ligji percakton drejtim nga specialistet te licensuar), shoqeria do te punesojeme kontrata pune specialist te licensuar sipas fushes perkatese.



5

MARRDHENIET FINANCIARE

NENI 23

Shoqeria mund të lidhë kontrata me sektore shtetërore, drejtperdrejt me tregun e lire, si dhe me persona fizike e juridike, vendas ose të huaj.

NENI 24

Ne marrdheniet kontratore, shoqeria përfaqësohet nga administratori ose nga persona të autorizuar prej tij. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqerine.

NENI 25

Shoqeria ka të drejtë të plotë të cele llogari likujduese pranë bankave të vendit ose të huaja në Shqipëri, shtetërore ose private dhe të kryejë veprimet e likujdimit nepermjet tyre. Për sigurimin e veprimtarisë ka të drejtë të vetfinancohet në leke ose në valute të huaj.

NENI 26

Shoqeria përgjigjet për kontributet fiskale, afatet e derdhjes së tyre dhe sigurimet shoqërore. Personat e ngarkuar me këto detyra duhet të mbajnë dokumentacinë të rregullt financiar.

Administratori në fund të vitit duhet të dorëzojë në organin tatimor përkatës bilancin e të ardhurave për efekt të tatimit vjetor.

Viti financiar mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

MARRDHENIET E PUNESIMIT

NENI 27



Administratori vendos për personat që do të punësohen në aktivitetin e shoqërisë. Punësimi do të bëhet në përputhje me aftësitë profesionale të punëmarresit.

NENI 28

Marrdheniet e punësimit rregullohen sipas kontratës së punësimit që lidhet midis paleve, në bazë të Kodit të Punës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në kontratë caktohen kushtet e punës, të pagesës, sigurimit në punë, ditëve të pushimit etj.

NENI 29

Administratori dhe personeli i shoqërisë është i detyruar të respektojë disiplinën e punës, të ruajë dhe të mirmbajë pronën dhe të zhvillojë aktivitetin e shoqërisë në përputhje me ligjin.



NENI 30

Ndaj shkeljeve te ndryshme zbatohen masa disiplinore qe merren nga administrator. Punonjesi qe largohet nga puna duhet te beje dorezimet e detyres ne baze ten je akti me shkrim, pasi tge kete shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

NENI 31

Cdo punonjes i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbushë detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes, nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti i shoqerise. Per shkelje te tilla dhe per shkelje te legjislacionit ne fuqi merren masa te ndryshme sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI

NENI 32

Te gjithë personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne fshehtesine e dokumentacionit, te informacionit, te njohurive te fituara si dhe te cdo lloj materiali tjetër konfidencial.

Ata duhet te adoptojne te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar hapjen e ketyre qofte edhe pjesisht.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 33

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve ndaj personave te trete, kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem.

NENI 34



Pagesat e personelit behen sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e punes dhe perqindjeve te tatimit te percaktuara nga organi administrative.

NENI 35

Ne rast te mbarimit te veprimtarise se shoqerise, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar perqindjet e mbartura nga vitet e meparshme, kalojne ne dispozicion te ortakeve sipas mases se kuotave qe zoterojne ne shoqeri.

NENI 36

Cmimet e sherbimeve te ofruara ne shoqeri si dhe ato te tregtimit caktohen ne baze te parimeve te ekonomise se tregut te lire. Fitimet e realizuara i nenshtrohen tatimit vjetor te percaktuar ne dispozitat perkatese ligjore.


ASMAA

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 37 SHKRIRJA

SHOQERIA mbaron me te perfunduar afati I parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji ose me ane te nje vendimi te asamblese se pergjithshme, dhe per shkaqe te tjera ligjore, falimentimi etj.

NENI 38 LIKUJDIMI

Ne rast mbarimi, SHOQERIA duhet te likujdohet, duke iu nenshtruar procedurave te likujdimit.

Per te administruar kete procedure, asambleja e pergjithshme e ortakeve emeron nje ose disa likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtarembi gjendjen e aktivitet dhe pasivitet te SHOQERISE, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likujdimin.

NENI 39

Shoqeria mund te mbaroje eshte me ane te riorganizimit, nepermjet formave te thithjes ose te bashkimit.

NENI 40

Gjate fazes se likujdimit, pergjegjesia e administratorit dhe likuidatorit eshte e njejte.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 41

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne ndonje institut sigurimi.

NENI 42

Mosmarreveshjet ne marredhenie me personat juridike e fizike, vendas e te huaj, zgjidhen me merkuptim, ne te kundert, gjykata kompetente eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

NENI 43

Cdo gje tjeter ne kete shoqeri I referohet Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

NENI 44


Shoqeria do te kete vulen e saj.

Statuti I shoqerise u miratua nga ortaku i vetem dhe u nenshkrua rregullisht prej tij.


ORTAKET E SHOQERISE "Vacation in Albania" SH.P.K

Znj. Asmaa Al Rabbat

Z. Feras Aldabak



Asmaa Alrabba



Feras Aldabak